



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË
BORDI I AKREDITIMIT

VENDIM

Nr. 14, datë 01.02.2019

PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË MANUALIN “VLERËSIMI I CILËSISË SË MËSIMDHËNIES NËPËRMJET PYETËSORIT KOMBËTAR TË STUDENTËVE” DHE PLANIT TË VEPRIMIT ME AFATET KOHORE TË RISHIKUARA PËR REALIZIMIN E “SONDAZHIT KOMBËTAR TË STUDENTËVE” TË RRADHËS

Bordi i Akreditimit, bazuar në Ligjin Nr. 80 datë 17.09.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ligji Nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, dhe Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. Ekstra 1, datë 02.02.2018 “Për miratimin e Rregullores së Bordit të Akreditimit”, pasi mori në shqyrtim ndryshimet në Manualin “Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet pyetësorit kombëtar të studentëve” dhe Planin e Veprimit me afatet kohore të rishikuara për realizimin e “Sondazhit Kombëtar të Studentëve” të rradhës,

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimet në Manualin “Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet pyetësorit kombëtar të studentëve”, sipas materialit bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Të miratojë Planin e Veprimit me afatet kohore të rishikuara për realizimin e “Sondazhit Kombëtar të Studentëve” të rradhës, sipas pikës 1 dhe bashkëngjitur këtij Vendimi.
3. Kryerja e SKS dhe respektimi i afateve kohore janë të realizueshme vetëm pas plotësimit të kapaciteteve infrastrukturore, logjistike dhe financiare, të nevojshme për realizimin e tij, parashikuar në materialin bashkëngjitur këtij Vendimi.
4. Ngarkohet Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për zbatimin dhe publikimin e këtij Vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I AKREDITIMIT